

Analiza e qeverisjes së hapur të Kuvendit të
Republikës së Kosovës (2023)

Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

ANALIZA E QEVERISJES SË HAPUR TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (2023)

RRETH PUBLIKIMIT

Ky dokument u zhvillua si pjesë e projektit '**Përmirësimi i Qeverisjes së Mirë 5.0&6.0**', i mbështetur nga **National Endowment for Democracy (NED)**, dhe i implementuar nga **Open Data Kosovo (ODK)**.

AUTORËT

Dafina Olluri dhe Anita Selita

VERSIONET GJUHËSORE

SHQ, ANG, SER

Përfunduar në PRILL, 2025 © ODK

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të NED. Riprodhimi dhe përkthimi për qëllime jofitimprurëse janë të autorizuara, me kusht që të dihet burimi dhe publikuesi të njoftohet paraprakisht dhe të dërgohet një kopje.

ANALIZA E QEVERISJES SË HAPUR TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (2023)

PËRMBAJTJA

Hyrje	1
Metodologjia e Hulumtimit	2
QASJA	3
NDËRGJEGJSIMI	5
INTEGRITETI	5
TRANSPARENCA	6
ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË AKTIVITETET E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	8
REKOMANDIMET	9

HYRJE

Në kontekstin e zhvillimeve të fundit politike dhe institucionale në Kosovë, transparenca dhe hapja e Kuvendit mbeten elemente thelbësore për forcimin e demokracisë dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Gjatë periudhës 2023-2024, Kuvendi i Kosovës ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për përmirësimin e funksionimit të tij, përfshirë implementimin e një sistemi të avancuar të votimit elektronik, i cili synon të rrisë efikasitetin dhe llogaridhënien institucionale. Megjithatë, sfidat në ndërtimin e konsensusit politik dhe në mbikëqyrjen efektive të qeverisë vazhdojnë të ndikojnë në performancën e Kuvendit në këtë drejtim.

Ky dokument analizon përpjekjet për rritjen e transparencës dhe hapjes së Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2023-2024, duke vlerësuar ndikimin e tyre në proceset demokratike dhe në besimin e publikut. Në një periudhë të karakterizuar nga polarizimi politik dhe sfidat në dialogun me Serbinë, forcimi i institucioneve demokratike dhe rritja e përfshirjes qytetare janë më të rëndësishme se kurrë.

Kjo analizë është zhvilluar si pjesë e vazhdueshme e raporteve të mëparshme të realizuara në kuadër të projektit NED 5.0 dhe NED 6.0. Duke krahasuar gjetjet e këtij viti me ato të viteve të mëparshme, ky dokument na mundëson të vlerësojmë më qartë progresin ose regresin në transparencën institucionale nga viti në vit. Ky krahasim përforcon objektivitetin e analizës dhe ofron një pasqyrë të qëndrueshme të trendeve të zhvillimit institucional.

Për të siguruar një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse, ODK në bashkëpunim me kompaninë UBO Consulting, realizoi një anketim me qytetarët, duke mbledhur mendimet dhe perceptimet e tyre mbi punën dhe transparencën e Kuvendit të Kosovës.

Duke u mbështetur në të dhëna të fundit, si dhe në analiza të institucioneve vendore ky dokument synon të ofrojë një vlerësim të gjendjes aktuale të transparencës në Kuvendin e Kosovës dhe të propozojë rekomandime konkrete për përmirësime të mëtejshme në drejtim të transparencës.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky hulumtim bazohet në të dhënat përfundimtare të vitit 2023 nga Indeksi Rajonal Institucional, i cili mat nivelin e transparencës dhe qasjes në informacion në Kuvendin e Kosovës. Analiza fokusohet në aspekte kyçe si publikimi i dokumenteve zyrtare, transparenca financiare, proceset e vendimmarrjes dhe mundësia që qytetarët të kenë qasje të lehtë në informacionet relevante që lidhen me punën e Kuvendit.

Të dhënat për këtë analizë janë mbledhur nga raportet e indeksit, dokumentet e publikuara nga Kuvendi dhe përgjigjet ndaj pyetësorëve të adresuar zyrtarisht institucioneve brenda Kuvendit. Në këtë punim janë vlerësuar katër parime themelore: transparenca, qasja në informacion, integriteti institucional dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve. Vlerësimi është realizuar duke analizuar faktorë si lehtësia e qasjes në dokumentet zyrtare përmes faqes së internetit të Kuvendit, cilësia e kuadrit ligjor për transparenca, burimet shitesë të informacionit të ofruara dhe mënyra e reagimit të Kuvendit ndaj kërkesave për informacion.

Hulumtimi është përqendruar në periudhën e vitit 2023-2024, duke marrë parasysh progresin e bërë në krahasim me gjetjet e raportimeve paraprake të zhvilluara në kuadër të analizave nga NED 1.0, 2.0, 3.0 dhe 4.0. Krahasimi i të dhënave ka ndihmuar në identifikimin e përparimeve të arritura, si dhe të sfidave që ende mbeten, ndërsa rekomandimet janë ndërtuar mbi analizat dhe vlerësimet më të fundit.

Hapja e Kuvendit 2021

Në vitin 2021, Kuvendi arriti një rezultat të përgjithshëm prej 86%. Ky përmirësim u arrit falë publikimit të të dhënave dhe dokumenteve zyrtare, duke i bërë ato më të lehta për t'u gjetur dhe për t'u përdorur nga qytetarët.

Hapja e Kuvendit 2022

Në vitin 2022, Kuvendi ka pasqyruar një rezultat të përgjithshëm prej 88% në hapje dhe transparenca.

Hapja e Kuvendit 2023

Në vitin 2023, rezultati i përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës mbeti i njëjtë si në vitin paraprak – 88%, ndonëse janë shënuar përmirësime në publikimin dhe qasjen në dokumente si projektligjet, buxhetet dhe raportet e punës. Pas sfidave të shkaktuara nga pandemia, kjo përfaqëson një stabilitet pozitiv krahasuar me vitet e mëhershme.

Përmes Planit të Veprimit për Kuvend të Hapur 2023–2026, Kuvendi ka rritur përfshirjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset legislative, në përputhje me standardet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP). Një nga arritjet kryesore është lansimi i platformës E-Pjesëmarrja, që u mundëson qytetarëve të komentojnë dhe të japin sugjerime për projektligjet.

Kuvendi ka filluar gjithashtu publikimin e dokumenteve parlamentare në formate të hapura dhe ka përmirësuar procedurat për qasje në dokumente publike, duke forcuar më tej transparencën dhe llogaridhënien. Përmes programit Ditët e Kuvendit, është rritur ndërveprimi mes deputetëve dhe qytetarëve në të gjithë Kosovën.

Megjithatë, sfida të caktuara mbeten, si krijimi i një kalendari të rregullt të debateve me qytetarët dhe sigurimi i qasjes së barabartë për personat me aftësi të kufizuara. Në përgjithësi, viti 2023 shënon një hap të madh drejt një Kuvendi më të hapur, më transparent dhe më gjithëpërfshirës për qytetarët e Kosovës.

QASJA

Parimi i qasjes mat nivelin e përfshirjes së qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe palëve të tjera të interesit në aktivitetet e Kuvendit të Kosovës, duke përfshirë aspekte si Ligji për Lirinë e Informacionit dhe rregulloret përkatëse. Në vlerësimin e vitit 2023-2024, Kuvendi i Kosovës arriti një rezultat domethënës në përmbushjen e kërkesave për transparencë dhe pjesëmarrje qytetare. Gjatë vitit 2023-2024, Kuvendi pranoi 33 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe i ka plotësuar të gjitha plotësisht, duke treguar angazhim të lartë në përmbushjen e të drejtës për informim.

Gjatë periudhës 2023–2026, Kuvendi ka miratuar dhe nisur zbatimin e Planit të Veprimit për Kuvend të Hapur 2023–2026, me synim rritjen e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset parlamentare. Ky plan ka ndikuar ndjeshëm në avancimin e hapjes institucionale përgjatë vitit 2024. Në këtë kuadër, Kuvendi ka vazhduar publikimin e rregullt të dokumenteve parlamentare, agjendave të seancave plenare dhe raporteve të punës në faqen zyrtare të institucionit.

Një nga arritjet më të rëndësishme të këtij viti është funksionalizimi dhe promovimi i platformës "E-Pjesëmarrja", e cila u mundëson qytetarëve të japin komente dhe sugjerime mbi projektligjet në shqyrtim. Kjo platformë shënon një hap thelbësor drejt digjitalizimit të pjesëmarrjes qytetare dhe rritjes së transparencës në proceset legjislative.

Për të lehtësuar më tej qasjen në informacion, Kuvendi ka ndërmarrë hapa konkretë për publikimin e dokumenteve në formate të hapura dhe të përpunueshme, si dhe ka organizuar trajnime për zyrtarët në fushën e qasjes në dokumente publike dhe të dhënave të hapura. Këto masa kanë për qëllim sigurimin e aksesit më të lehtë dhe përdorimit të informacionit nga publiku.

Në kuadër të përpjekjeve për të forcuar ndërveprimin mes deputetëve dhe qytetarëve, Kuvendi ka vijuar me organizimin e programit “Ditët e Kuvendit”, duke zhvilluar debate dhe takime në qytete të ndryshme të Kosovës. Gjithashtu, është organizuar edhe "Java për Parlament të Hapur", që ka shërbyer si platformë për diskutime dhe bashkëpunim mes Kuvendit dhe qytetarëve. Megjithatë, sfida të caktuara mbeten që kuvendi ka ende nevojë të punojë në ato drejtime. Sipas informacionit të përditësuar në vitin 2023-2024, Kuvendi ende nuk ka miratuar një Kod të Sjelljes për deputetët, siç kërkohet nga Rregullorja e re e Kuvendit, duke ndikuar në nivelin e përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Për më tepër, raporti i Institutit të Kosovës për Drejtësi për vitin 2023 vëren se mungesa e sistemit të votimit elektronik vazhdon të kufizojë qasjen e qytetarëve në informacionin mbi përfaqësimin e tyre.

Në përgjithësi, Kuvendi i Kosovës ka shënuar një përmirësim të dukshëm gjatë viteve të fundit, duke bërë një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një Kuvendi më transparent, gjithëpërfshirës dhe të hapur për qytetarët e Kosovës, duke forcuar themelet e demokracisë dhe inkurajuar pjesëmarrjen aktive në proceset vendimmarrëse.

Përveç këtyre përmirësimeve në qasje që ka bërë, Kuvendi i Kosovës ka ende nevojë për disa ndryshime specifike që nuk i ka realizuar.

- Kuvendi ende nuk ka krijuar një kalendar i rregullt për debatet publike me qytetarët, dhe mungon qasja e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë mungesën e dokumenteve në alfabetin Braille.
- Është e domosdoshme përmbyllja e rishqyrtimit dhe miratimit të Kodit të Etikës për deputetët për të forcuar besueshmërinë dhe përgjegjësinë publike.
- Po ashtu, duhet të implementohet sistemi i votimit elektronik për të garantuar transparencë dhe përfaqësim të drejtë.
- Kuvendi duhet të vazhdojë përmirësimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar dokumente në formate të aksesueshme dhe lehtësira infrastrukturore.
- Së fundi, krijimi i një kalendari të rregullt për debate publike do të ndihmonte në përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset legislative.

NDËRGJEGJSHMËRIA

Në kategorinë e Kushtetutshmërisë, Kuvendi i Kosovës ka arritur një rezultat prej 90%, duke shfaqur një përmirësim të qëndrueshëm gjatë viteve. Ky aspekt ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e politikave të zbatuara në Kuvend. Rëndësia e vlerësimit të ndikimit qëndron në aftësinë e tij për të nxjerrë në pah raste të politikave dhe ligjvënies joefektive.

Gjatë vitit 2023 dhe 2024, Kuvendi i Kosovës ka ndërmarrë hapa të qartë për të rritur transparencën dhe llogaridhënien. Plani Strategjik i Kuvendit 2022–2026 dhe Plani i Veprimit për Kuvend të Hapur 2023–2026 kanë qenë bazë për aktivitetet e fundit. Të dy dokumentet kanë udhëhequr përpjekjet për të hapur më shumë proceset e brendshme dhe për të afruar qytetarët me institucionin.

Në këtë periudhë, Kuvendi ka vazhduar të transmetojë në kohë reale të gjitha seancat plenare si në audio ashtu edhe në video. Përveç kësaj, qytetarët kanë pasur mundësinë të përdorin platformën E-Pjesëmarrja, ku kanë adresuar çështje dhe rekomandime. Shoqëria civile ka qenë aktive në Forumin për Transparencë Parlamentare, duke ndikuar drejtpërdrejt në përpilimin e iniciativave të reja ligjore.

Në aspektin e mbikëqyrjes financiare, Zyra Kombëtare e Auditimit i ka raportuar Kuvendit për shpenzimet e qeverisë gjatë vitit financiar 2023. Auditori i Përgjithshëm ka dorëzuar raportin e rregullt, ku është shqyrtuar mënyra se si janë menaxhuar fondet publike dhe janë dhënë rekomandime për përmirësime.

Në vitin 2023, Kuvendi ka zhvilluar 36 seanca parlamentare dhe ka trajtuar një interpelancë ndaj qeverisë. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike ka qenë 33, dhe të gjitha janë trajtuar plotësisht. Ndërkohë, janë propozuar gjithsej 73 projektligje: 4 prej tyre nga deputetët dhe 69 nga Qeveria, ndërsa nga qytetarët nuk ka pasur asnjë propozim për ligj.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë miratuar 18 ligje përmes procedurës së përshpejtuar, një praktikë që përdoret për të përshpejtuar kalimin e ligjeve kur ka urgjenca ose dakordim të gjerë politik.

Për të rritur ndëgjegjshmërinë e brendshme, Kuvendi ka organizuar dhe marrë pjesë në trajnime për qasje në dokumente publike dhe për përdorimin e të dhënave të hapura. Në vitin 2023-2024, ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të ngritur kapacitetet e nëpunësve civilë në fushën e transparencës dhe të komunikimit me publikun.

Në fushën e teknologjisë, Kuvendi ka vazhduar të mbështesë përdorimin e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara për shkëmbimin e dokumenteve zyrtare. Kjo ka ndihmuar në ruajtjen e sigurisë dhe efikasitetit në proceset administrative.

INTEGRITETI

Integriteti institucional në Kuvendin e Kosovës për vitet 2023–2024 ka njohur zhvillime të rëndësishme prej 95%, veçanërisht në fushat e transparencës, etikës parlamentare, deklaramit të pasurisë dhe rregullimit të aktiviteteve të lobimit. Këto zhvillime janë rezultat i një kombinimi të përpjekjeve të brendshme të Kuvendit dhe presionit të vazhdueshëm nga shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë për të forcuar standardet e qeverisjes së mirë.

Në fushën e deklaramit të pasurisë, deputetët janë të detyruar të paraqesin deklaratat e tyre të pasurisë, të ardhurave dhe detyrimeve financiare pranë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK). Gjatë vitit 2023, dorëzimi i deklaratave është bërë në përputhje me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, ndërsa APK ka ndërmarrë hapa për thellimin e verifikimit të deklarameve, duke forcuar kontrollin mbi të dhënat e zyrtarëve publikë. Aksesit në këto deklarata mbetet i mundur përmes kërkesave formale, në respektim të ligjeve për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të të dhënave personale.

Në aspektin e etikës parlamentare, Kuvendi ka bërë përparime të dukshme përmes hartimit të një Kodi të Etikës për Deputetët. Procesi i përgatitjes së Kodit nisi në vitin 2022 dhe gjatë vitit 2023 u hap për konsultim publik. Kodi synon të vendosë standarde të qarta për sjelljen e deputetëve, duke përfshirë parandalimin e konfliktit të interesit, respektimin e integritetit të institucionit dhe sjelljen profesionale gjatë punës parlamentare. Megjithatë ky Kod nuk është miratuar ende dhe miratimi i tij pritët të shqyrtohet nga Komisioni për Legjislacion dhe Etikë në vitin 2025.

Për të siguruar zbatimin efektiv të Kodit të Etikës, Projekt-Rregullorja e re e Kuvendit parasheh themelimin e një Komisioni Parlamentar për Etikë. Ky mekanizëm pritët të ketë mandat të qartë për të monitoruar zbatimin e rregullave të etikës, shqyrtuar shkeljet e mundshme dhe rekomanduar masa disiplinore të përshtatshme. Pavarësia dhe funksionaliteti i këtij komisioni do të jenë faktorë kyç për garantimin e integritetit të brendshëm të Kuvendit.

Një sfidë e rëndësishme mbetet mungesa e një kuadri ligjor për rregullimin e aktiviteteve të lobimit. Aktualisht, Kuvendi i Kosovës nuk disponon një ligj të posaçëm për lobimin, çka përbën një boshllëk të identifikuar edhe nga raportet e organizatave të shoqërisë civile. Gjatë vitit 2023, janë shfaqur shqetësime në lidhje me marrëveshjet lobuese të qeverisë jashtë vendit, shumë prej të cilave mbeten të klasifikuara si konfidenciale, duke kufizuar kështu transparencën dhe llogaridhënien publike. Kjo çështje është tashmë prioritet në Planin e Veprimit për Kuvend të Hapur 2023–2026, i cili synon hartimin dhe miratimin e një ligji të posaçëm për lobimin.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve institucionale, gjatë viteve 2023 dhe 2024 janë organizuar trajnime të dedikuara për nëpunësit civilë të Kuvendit në fushat e qasjes në dokumente publike, të dhënave të hapura, etikës publike dhe parandalimit të korrupsionit. Këto trajnime kanë synuar të forcojnë kulturën e transparencës dhe të integritetit në administratën parlamentare.

TRANSPARENCA

Vlerësimi i transparencës së Kuvendit të Kosovës për periudhën 2023–2024 është bërë duke analizuar tri fusha kryesore: informacionin organizativ, prokurimin publik dhe menaxhimin e buxhetit të shtetit. Bazuar në të dhënat e dokumentit të vlerësimit, transparenca e përgjithshme e Kuvendit është vlerësuar në nivelin 91%.

Në pjesën e informacionit organizativ, Kuvendi ka publikuar në faqen e tij zyrtare informacione të rëndësishme si struktura organizative, përbërja e komisioneve parlamentare, biografitë e deputetëve dhe agjendat e seancave plenare. Kjo ka ndihmuar qytetarët dhe organizatat e interesuara të kenë qasje më të lehtë në punën e Kuvendit. Megjithatë, disa dokumente të tjera si procesverbalet e plotë të mbledhjeve të komisioneve dhe raportet e hollësishme të punës së deputetëve shpesh publikohen pjesërisht ose me vonesë, çka e kufizon nivelin e përgjithshëm të transparencës.

Në fushën e prokurimit publik, Kuvendi ka përmbushur obligimin për të publikuar planet e prokurimit dhe kontratat përmes platformës elektronike. Kjo tregon për një përmirësim krahasuar me të kaluarën. Megjithatë, detajet mbi mënyrën si janë vlerësuar ofertat dhe arsyetimet pse janë përzgjedhur fituesit nuk janë të plota, duke lënë hapësirë për paqartësi dhe dyshime në proces.

Përsa i përket buxhetit të shtetit, Kuvendi ka publikuar buxhetin vjetor dhe raportet financiare, duke ndihmuar kështu në rritjen e transparencës fiskale. Megjithatë, mungesa e raporteve të rregullta mbi realizimin e buxhetit dhe mungesa e analizave të thelluara e bëjnë të vështirë ndjekjen nga afër të mënyrës sesi menaxhohen fondet publike.

Në përgjithësi, Kuvendi i Kosovës ka bërë përparime në hapjen dhe transparencën e tij, por ende ka sfida të rëndësishme që duhet të adresohen. Nevojitet publikimi më i plotë i dokumenteve të brendshme, rritja e transparencës në proceset e prokurimit dhe përmirësimi i raportimit financiar, në mënyrë që Kuvendi të përmbushë plotësisht standardet e llogaridhënies dhe besimit publik.

ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË PUNËN E MASHTI SË NË KOSOVË

ODK në bashkëpunim me UBO Consulting gjate muajit dhjetor 2023 ka realizuar një anketë për të kuptuar se si qytetarët e shohin dhe përjetojnë punën e Kuvendit të Kosovës. Në këtë hulumtim janë pyetur 1310 qytetarë nga mosha, gjinia, etnia dhe vendbanime të ndryshme në gjithë Kosovën. Qytetarët janë pyetur nëse besojnë që mund të ndikojnë në punën e Kuvendit, dhe vetëm 29.2% kanë thënë se po, ndërsa shumica nuk e ndjejnë veten të fuqizuar për të kontribuar.

Në anën tjetër, kur u pyetën për kënaqshmërinë me punën e Kuvendit, 41.5% u shprehën se janë "disi të kënaqur", dhe vetëm 7.2% thanë se janë "shumë të kënaqur". Këto rezultate tregojnë se shumë qytetarë ndihen larg vendimmarrjes dhe ka nevojë për më shumë hapësira ku ata mund të dëgjohen dhe të japin mendimin e tyre. Sa më shumë të përfshihen qytetarët, aq më i fortë dhe demokratik bëhet Kuvendi.

REKOMANDIMET

HAPAT E VEPRIMIT

1. **Miratimi i menjëhershëm i Kodit të Etikës për Deputetët:** Për të rritur llogaridhënien dhe integritetin institucional, Kuvendi duhet të përmbyllë dhe miratojë Kodin e Etikës, duke vendosur standarde të qarta për sjelljen e deputetëve.
2. **Zbatimi i sistemit të votimit elektronik:** Për të garantuar transparencë më të madhe në proceset e vendimmarrjes dhe përfaqësimit, Kuvendi duhet ta implementojë sa më shpejt sistemin elektronik të votimit, që qytetarët të kenë mundësi të shohin sesi votojnë përfaqësuesit e tyre.
3. **Zhvillimi i një kalendari të rregullt për debatet publike:** Kuvendi duhet të krijojë një orar të hapur dhe të parashikueshëm për debate publike me qytetarët, që ata të kenë mundësi të japin ide dhe komente për çështje me rëndësi.
4. **Përmirësimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara:** Sigurimi i dokumenteve në formate të aksesueshme (si Braille, audio, dokumente të lehta për lexim) dhe përmirësimi i infrastrukturës së Kuvendit për t'u bërë më gjithëpërfshirës.
5. **Përmirësimi i transparencës në prokurim dhe financa:** Kuvendi duhet të publikojë informacione më të plota për procedurat e prokurimit, vlerësimin e ofertave dhe arsyetimin e vendimeve, si dhe të raportojë më rregullisht mbi realizimin e buxhetit.
6. **Promovimi dhe zgjerimi i përdorimit të platformës “E-Pjesëmarrja”:** Të ndërmerren fushata informimi për të inkurajuar qytetarët të përdorin këtë platformë për të kontribuar aktivisht në proceset legislative.
7. **Hartimi dhe miratimi i një ligji për lobimin:** Kuvendi duhet të hartojë dhe miratojë një kuadër ligjor që rregullon aktivitetet e lobimit, për të siguruar më shumë transparencë dhe për të parandaluar konfliktet e interesit.

REKOMANDIMET

HAPAT E VEPRIMIT

8. **Rritja e publikimit të dokumenteve dhe informacionit në kohë reale:** Duhet të përmirësohet publikimi i procesverbaleve të plotë të komisioneve, raporteve të detajuara të punës së deputetëve dhe të gjitha dokumenteve të rëndësishme parlamentare.
9. **Fuqizimi i trajnimeve për transparencë dhe qasje në të dhëna:** Vazhdimi i trajnimeve për nëpunësit civilë dhe deputetët për përdorimin e të dhënave të hapura dhe qasjen në dokumente publike, për të forcuar një kulturë të re institucionale më të hapur dhe të përgjegjshme.
10. **Zgjerimi i komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët:** Përveç "Ditëve të Kuvendit", Kuvendi mund të zhvillojë edhe konsultime online, "dëgjesa virtuale" dhe forume të hapura në rrjete sociale për të rritur ndërveprimin me qytetarët.

RAPORTE TË TJERA TË NGJASHME

RAPORTE TË TJERA

Eksploroni raporte dhe dokumente shitesë të ngjashme me këtë raport të disponueshme në faqen e publikimeve të Open Data Kosovo.

WWW.OPENDATAKOSOVO.ORG/PUBLICATIONS

Nëse keni pyetje shitesë, mos ngurroni të kontaktoni:

info@opendatakosovo.org